



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/03-25187/22
Kaçanik, 16.09.2022

PROCESVERBAL

Nga Dëgjimi publik me qytetarë –Administratorë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, OJQ, Përfaqësues të shkollave dhe grupe tjera të interesit, organizuar nga Kryesuesi i KK në bashkpunim me KPF.

Dëgjimi publik u mbajt në sallën e KK, me fillim pune në ora 11:00.

Evidencia e pjesëmarrësve është si në listën e bashkëngjitur (përfaqësues nga OJQ, Administratorë të fshatrave, anëtarë të KK, anëtarë nga ekzekutivi, zyrtar komunal).

Dëgjinimin publik e kryesoj Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtëse Makfire Malsiu.

Tema: Propozim Buxheti për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025.

Kryesuesi i Kuvendit: Fillimisht i njoftoj pjesëmarrësit për aktivitetin e Ekzekutivit të komunës në mbajtën e dëgjimeve publike për buxhetin, më pastaj draftin ia ka përcjellë KK ashtu si e përcakton LVL, me 1 shtator. Gjatë kësaj periudhe është në obligim ligjor organizimi dhe mbajtja e dëgjimit publik nga KPF para se të dalë në KK. Ligji e përcakton qartë që qytetarët bëhen pjesë e vendimmarres në dëgjime publike, mirëpo pjesëmarrja e qytetarëve nuk është e kënaqshme se disa kanë marrë pjesë në takime të organzuara nga ekzekutivi dhe nuk e shohin të arsyeshme të janë pjesë e këtij debati. Buxheti i vitit 2023 është 10,674,898 €. Shpenzimet buxhetore janë të ndara në 5 shtylla: Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale; Subvencione dhe Transfere, Investime Kapitale. Për sqarime me të hollësishme mund të na jepin, Nënkyetari i Komunës dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa.

z. Sabedin Vishi- Nënkyetar Komune- Buxheti i vitit 2023 për herë të parë është: 10,674,898 €. Pjesa që jemi me të interesuar me ditur janë: Investimet Kapitale. Për këtë pozicion janë paraparë 2.971,313.00€. Në vazhdim nënkyetari sqaroj për shumat e projektuara nga Granti i përgjithshëm qeveritar, Granti i Arsimit, Granti i Shëndetësisë si dhe të Hyrat vetjake komunale, ndërkaq shqetësimi ynë është si e potencoj edhe kryesuesi, pjesëmarrje e ulët e qytetarëve. Materialin e keni, për me tepër sqarime do të jep drejtori i DBF, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi- drejtori i Buxhetit dhe Financave: Sqaroj për buxhetin e projektuar për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025 dhe dëgjimet publike të mbajtura nga ekzekutivi i komunës. Të gjithë sektorët në vazhdimësi i kanë kërkesat qytetarët për

prioritete dhe mbi bazë e tyre është planifikuar buxheti. Buxheti për vitin 2023 është 10,674,898 € me 16% ngritje. Shpërndarja: Paga dhe Mëditje, 5, 621,607.00€, Mallra dhe Shërbime, 1,498,269.00€, Shërbime Komunale, 193,500.00€, Subvencione dhe Transfere, 390,000.00€, Shpengime Kapitale, 2,971,313.00€ apo 28%. Në vazhdim drejtori sqaq shpenzimet e planifikuar në secilën kategori, ndërkaq e lexoj listën e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2023.

Kryesuesi i Kuvendit: I dëgjuat sqarimet e ekzekutivit të komunës, e hapi debatin:

z. Rrustem Zenuni- anëtar i KK nga PDK: Propozoj të hynë në planifikim buxhetor:

1. Rregullimi i terreneve sportive në f. Duraj;
2. Ndriçimi publik në rrugën "Heredin Fazliu" në gjatësi të rrugës 400m.
3. Hapja dhe rregullimi i rrugës në f. Semajë – Gaçkë;
4. Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Ahmet Kaçiku" nga "Fusha e Pajtimit" – Restoran "Natyra", në vitin 2023;
5. Rregullimi i kanalizimit në zonat industriale nga f. Doganaj- "Fusha e Pajtimit" dhe nga Restoran "Evropa - "Fusha e Pajtimit";
6. Rregullimi i ujësjellësit në f. Bajnicë.
7. Ndara e mjeteve buxhetore nga DUKMM për rregullimin e çështjes së pronave, ku qytetarët i lëshojnë pronat për ndërtimin e rrugëve dhe trotuareve.

Kryesuesi i kuvendit: Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë të mëdha, ndërkaq mundësitet buxhetore janë këto që janë. Buxheti i vitit 2023 është 10,674,898 €, ndërkaq nga ky buxhet për Investime Kapitale (IK) janë: 2,971,313.00€ - kjo mundësia maksimale e shpërndarje se buxhetit për IK. Trotuari që e ceku z. Rrustem Zenuni, është në planifikim buxhetor, 5,000.00 € në vitin 2023 dhe nga 100,000.00 € në vitet 2024-2025. Ajo rrugë është regionale dhe në një bashkëpunim me të madh me MTI mundet me u kryer ky projekt nga ministria, e mos me i shpenzuar mjetet e komunës në këtë projekt, se është në obligim të kësaj ministrie, se ne vetëm një gyp me rregulluar ne atë rrugë, duhet me marrë leje nga MTI.

znj. Arditia Rahmani-anëtare e KK nga LDK: Edhe unë shprehi shqetësimet e mijë për prezencë jo të mirë të qytetarëve, karshi kërkesave dhe nevojave që ka vendi. Në këtë planifikim buxhetor shihet se nuk ka kod të ri buxhetor për projektin" Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Idriz Seferi"- kodi për këtë rrugë është i bartur. Kjo të bënë me kuptuar se nuk ka asgjë prej kësaj pune, kjo është për keqardhje. Në anën tjetër po shihet se ka kode të reja buxhetore dhe mjete të shumta të parapara, duke mos anashkaluar asnjëherë nevojën për realizimin e kërkesave dhe projekteve të parapara, por çështja është sesi po i iu jap prioritet komuna projekteve që po i bart vit pas viti, me këtë buxhet. Po flas për rrugën "Idriz Seferi" –rrugë kjo 100m nga komuna dhe është turp për të gjithë ne që nuk është arritur me bërë diçka me tepër për këtë rrugë. Uroj me pësuar ndryshim draft buxheti e me u futur kjo rrugë në këtë planifikim buxhetor për ndërtim.

z. Ziber Luma- përfaqësues i f. Glloboçicë: Shprehi shqetësime për mos përfshirje të f. Glloboçicë në këtë planifikim buxhetor, ndërkaq i përmendi nevojën e fshatit për asfaltimin e rrugicave, ndriçimin publik, çështjen e problemeve që ka ky fshat me ujërat e zeza, ndërtimin e sallës së edukatës fizike- projekt ky i premtuar nga kryetari në përurimin e shkollës "AvdylGafurr Luma". Në vazhdim z. Luma paraqiti shqetësimet e një kthese të rrezikshme të rrugës në Glloboçicë, ka pasur edhe pasoja, kemi biseduar me kryetarin

Besim Ilazin për këtë punë. Rrethoja mbrojtëse është shkatërruar, por nuk është përfshirë në buxhet, trotuari është lënë në gjysmë – kjo ka qenë kompetencë e MTI, por ka mbetur ashtu në gjysmë. Të nënkalimi – ujerat e zeza rrjedhin në asfalt, shkaku i një shkarpe. Jemi duke shtuar kapacitetet e ujit, ndërkaq projektuesit a i marrin parasysh do çështje se janë profesional e mos me u bërë punët shkel e shko, se ka raste kur gypat mbisin mbi tokë, kjo është brengose? Për fund, po e theksoj edhe njëherë, Glloboçica duhet të jetë pjesë e këtij buxheti.

Nënkyetari i Komunës: Në f. Glloboçicë, punimet të kjo e fundit të ky fshat, sivjet është investuar në ujësjellës në shtimin e kapacitetit të ujit dhe në kanalizim. Javën tjetër kemi me dalë me shikuar bazenin dhe gypin. Sivjet janë paraparë 230.000.00€ ku përfshihen; Dubrava, Glloboçicë, Ivajë dhe 7 fshatra tjera për shtimin e kapaciteteve të ujit. Të rrugicat, për sivjet nuk janë planifikuar, duhet pritur vitin e ardhshëm, me kodin e projekteve: rehabilitimi i rrugëve rurale në shumë: 400.000.00€. Të rruga “Idriz Seferi”, ka fjalë mos po shtrohet prej Holande. Drejtori i DUKMM besoj se ka me shumë informata, në këtë projekt është e përfshirë edhe ministria.

zpj. Ardit Rrahmani: Ne e dimë se debati për rrugën “Idriz Seferi” është shteruar në mbledhjet e kaluara. Ne prit ministrinë, ministria prit nivelin lokal. Ne u pajtuam që kryetari me u angazhuar me arritur një marrëveshje me ministrinë, por si duket nuk ka asgjë në këtë drejtim.

Nënkyetari i Komunës: Sa me kujtohet mua, kryetari ka kërkuar edhe nga anëtarët e KK që kanë ndikim me ndihmuar me arritur marrëveshjen me ministrinë për këtë rrugë, ndërkaq ne jemi dëshmitarë të asaj se as zëvendësministrat nuk dëgjojnë me u takuar.

zpj. Ardit Rrahmani: Unë e kam shprehur vullnetin me kontribuar në këtë drejtim, ndërkaq nuk jam ftuar nga kryetari, atëherë me cilët asamblistë ka pasur mundësi me arritur marrëveshjen?

zpj. Fitore Vishi: Prezantoj 2 kërkesa të fsh. Runjevë:

1. Zgjerimin e urës, sepse ura është shumë e ngushtë për me kaluar 2 vetura dhe kjo paraqet rrezik për nxënës dhe qytetarë tjerë 2. Rregullimi i rrugës që dërgon të varrezat e f. Runjevë, sepse kjo rrugë është jashtëzakonisht e vështirë për të ecur. Unë kam pasur biseda edhe me drejtorin për këto 2 projekte. Realizimi i këtyre 2 projekteve nuk janë të kushtueshme.

z. Ziber Luma- Përfaqësues i f. Glloboçicë: Është një problem që po na përcjellë në f. Glloboçicë lidhur me ujërat e zeza. Shumica i kanë bërë lidhjet e kanalizimeve strehëve të shtëpive, e që nuk është i paraparë për ujërat atmosferike. Është mirë me marrë një vendim urgjent me i hequr lidhjet e kanalizimeve që i kanë bërë strehëve të shtëpive, sepse gjatë të reshurave atmosferike, në pikën me të ulët, po hyjnë edhe nëpër shtëpia.

z. Qamil Stagova: Zgjerimi i urës në f. Runjevë është me plan sivjet për rregullimin e rrugëve lokale, ndërkaq për rregullimin e rrugës për të varrezat e f. Runjevë, banorët kanë kërkuar pllaka prej shëtitores. Pllakat janë dhënë, por nuk është e paraparë me i shtruar komuna. Drejtori i shërbimeve Publike ka të dhëna me tepër për këtë çështje.

z. Ibrahim Dalloshi- përfaqësues i f. Soponicë: Ashtu si e potencoj edhe z. Rrustem Zenuni për çështjen e rrugëve të cilat qytetarët i kanë lëshuar pronat, të rregullohet sa me parë çështja e bartjes së pronave në pronë komunale. Projektet e parapara të ndërtohen, e jo vetëm të i epën punë kryesit e mos të rregullohen, sepse në 4 projekte nuk e di se a ka dalë kush me shikuar se çka është duke u punuar, si të trotuari, rruga në Kamenica e kështu me radhë.

Nënkyetari i Komunës: Zyrtarët komunal dalin në mbikëqyrje të projekteve, ndërkaq trysni duhet me iu bërë për me u përmirësuar. Nëse shihni ndonjë parregullsi, duhet me na njoftuar se ne jemi për atë që me u rritur cilësia në punë. Të kanali i ujitjes, trotuari është rregulluar me tepër se gjysma, ndriçimi publik është përmirësuar.

z. Fatmir Bunjaku- anëtar i KK nga PDK: Sa i përket planifikimit buxhetor, deri diku jam i kënaqur, por ka edhe mungesa. Në 3 lagje të Biçecit: Shorr, Bektesh dhe Zhark. Iu përgëzoj përrugën, se ujërat atmosferike kanë dalë disa herë aty, ndërkaq nuk e pash se ka me u zgjerua rruga: "Fadil Bunjaku"- rruga alternative dhe rehabilitimi i saj. A do të ketë ndryshim në këtë projekt kapital, apo ka me u zbatuar ashtu siç është.

Nënkyetari i Komunës: Çështja e rrugës, Shorr, Bektesh, Zhark, ju e dini se ka probleme pronësore juridike. Derisa nuk zgjidhen problemet, ne nuk mundem me bërë kurrfarë zgjerimi të rrugës. Për f. Biçec, në vitin e ardhshëm është në prioritet salsa e sportit, 200,000.00 € për këtë projekt, pastaj rruga "Abit Dullovci" janë paraparë 80.000€. 100,000.00€ janë për kanalizim.

z. Fatmir Bunjaku: Çështja e ujërave të zeza është më urgjente, sepse nga 3 lagje, vijë ujërat e zeza të Bektesht dhe Zharkt.












Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, takimi u mbyllë në ora 14:40.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu


Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Lista e Pjesëmarrjes në Dëgjimin Publik të organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me KPF, për temën: Propozim Buxhetin për vitin 2023 dhe vlerësimet 2024-2025

| Nr. rend. | Emri dhe Mbiemri | Përfaqësimi | Nënshkrimi |
|--------------|------------------------------|-----------------------|---|
| 1. | UHIM THAFLI | UP TOJOTHI |  |
| 2. | Ftore Vishi | Antare e Kuvendit RPK |  |
| 3. | Fatmir | Antar e kuvendit |  |
| 4. | ZIBER LUKA | Fsh. Gilloboçicë Adm. |  |
| 5. | Fadil Gollami | Zyrtar |  |
| 6. | Ibrahim Doloshi | F. Soponja |  |
| 7. | Danushtrim Ferizaj F. Drroi | |  |
| 8. | Kemal Museli | Kryesues i Kuvendit |  |
| 9. | Fatihue Gjon Selami | Zyn. për Informacion |  |
| 10. | Andita Rahmani | K. Komunal LDK |  |
| 11. | BAHRI SELMI | U. KOMUNAL - ENEBONI |  |
| 12. | Malixhe Matric | Zyrtar e UK |  |
| 13. | Sabedin Vishi | Nënshkrimi |  |
| 14. | Kofseze Koxha | auditore e brendshme |  |
| 15. | SALI MALSU | DREJTORI DSMS |  |
| 16. | QAMIC STAFQOUT DREJTOR OUKMA | |  |
| 17. | | | |
| 18. | | | |
| 19. | | | |
| 20. | | | |
| 21. | | | |

| | | | |
|-----|--|--|--|
| 22. | | | |
| 23. | | | |
| 24. | | | |
| 25. | | | |
| 26. | | | |
| 27. | | | |
| 28. | | | |
| 29. | | | |
| 30. | | | |
| 31. | | | |
| 32. | | | |
| 33. | | | |
| 34. | | | |
| 35. | | | |
| 36. | | | |
| 37. | | | |
| 38. | | | |
| 39. | | | |
| 40. | | | |
| 41. | | | |
| 42. | | | |
| 43. | | | |
| 44. | | | |
| 45. | | | |



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

| | | | |
|----------|------------|--------|---------|
| Data: | 05.09.2022 | Vendi: | KAÇANIK |
| Nj. org. | 01 | Numri | Shtojcë |

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Kryesuesi i Kuvendit

FTESË PËR DËGJIM PUBLIK

Të nderuar qytetarë të komunës së Kaçanikut,
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe
financa, organizojnë Dëgjim Publik me Administratorë të fshatrave, vendbanimeve dhe
lagjeve urbane, OJQ, përfaqësues të shkollave dhe grupe tjera të interesit.

Data dhe koha: Dëgjimi publik do të mbahet me datë **16.09.2022 (e Premte)**, me
fillim pune në ora **14:00**.

Vendi: Në sallën e Kuvendit të Komunës

Tema: Propozim Buxheti për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025

Propozim Buxheti për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025, është i publikuar
në web faqen e komunës së Kaçanikut.

Ju mirëpresim!

